

J.M. Coetzee
ASKUND

roman

Përktheu nga origjinali:
Zymber Elshani



Skanderbeg Books

Original title: *In the Heart of the Country*

Copyright © J.M. Coetzee, 1976, 1977

All rights are reserved by the Proprietor throughout the world. By arrangement with Peter Lampack Agency, Inc., 551 Fifth Avenue, Suite 1613, New York, NY 10176-0187 USA

© Albanian translation: Skanderbeg Books, Tiranë, 2003, 2010

Kujdesi për botimin: Flutura Aça

ISBN 978 99943 51 54 1

1. Sot im atë solli në shtëpi nusen e tij të re. Ata erdhën të shtrënguar dorë për dorë, të pluhurosur nga udhëtimi i gjatë nëpër rrafshina, në karron me dy rrota e tërhequr nga një kalë, në ballin e të cilit tundej një pupël struci. Apo mbase, karroja tërhiqej nga dy gomarë me xhufka të vëna si stoli, kjo është e mundshme, pse jo. Im atë kishte veshur setrën e zezë bishtdallëndysheje dhe kapelën cilindrike, nusja e tij një kapele dielli me strehë të gjerë dhe fustan të bardhë të shtrënguar në bel dhe fyt. Hollësi të tjera nuk mund t'ju jap, se nisa të qëndis dhe nuk munda të shihja më. Isha në dhomën time, në gjysmerrësirën ngjyër smeraldi të pasdites vonë në shtëpinë me kanate të tërhequr, e mbyllur, duke lexuar një libër ose, ka më shumë të ngjarë, e shtrirë në shpinë me peshqir të lagur mbi sy, duke luftuar migrenën. Jam njëra nga ato vajza që rri në dhomën e saj, qoftë duke lexuar, qoftë duke shkruar, qoftë duke luftuar migrenën. Kolonitë janë plot me vajza të tilla, por, asnjëra, ma merr mendja, s'është aq e ashpër, si unë. Im atë është njëri nga ata, që ecën dyshemesë me dërrasa para-prapa para-prapa me çizmet e tij të ngadalshme të zeza. Dhe ja, një e tretë, është nusja e re, e cila fle deri vonë në shtrat. Ata janë kundërshtarët e mi.

2. Gruaja e re. Gruaja e re është një grua epshtndjellëse, e shkathët si një mace, kockëmadhe dhe përtace, me gojë të gjerë dhe buzëqeshje të lehtë. Sytë e saj janë të zinj dhe të mprehtë, si dy kokrra mani, si dy kokrra të zeza mani. Ajo është një grua e madhe, me kyçet e duarve finë dhe gishta të plotë, të gjatë e të drejtë. Ushqimin e ha me ëndje. Ajo fle, dhe ha, dhe dembelohet. Nxjerr deri në fund gjuhën e saj të gjatë e të kuqe, dhe lëpin me

buzë mishin e majmë e të shijshëm të deles. “Ah, këtë e pëlqej!”, thotë ajo, qesh dhe rrotullon sytë. Shoh e magjepsur gojën e saj. Atë çast, kthen nga unë fytyrën e gjerë e të buzëqeshur dhe sytë si dy kokrra mani të zinj. Unë nuk mund ta duroj buzëqeshjen e saj. Kur jemi kështu, së bashku, ne nuk jemi një familje e lumtur.

3. Ajo është gruaja e re, pasi gruaja e mëparshme ka vdekur. Gruaja e mëparshme, ishte nëna ime, por vdiq shumë vite më parë, aq sa mezi e kujtoj. Duhet të kem qenë shumë e vogël, kur ajo vdiq, mbase foshnjë e sapolindur. Nga një birucë e largët kujtese, unë nxjerr një figurë të shtrajtshtime, figurën e vagëlluar e të hirtë, të brishtë e të dobët fizikisht, të nënës sime të dashur, të kruspulloshur në dysHEME, të tillë, që afërmendsh një vajzë në gjendjen time do të sajonte vetë.

4. Gruaja e parë e tim eti, pra, nëna ime, ishte një grua e butë, delikate dhe e dashur, e cila jetoi dhe vdiq nën zap të të shoqit. Burri i saj nuk ia fali kurrë pamundësinë për t'i dhënë një djalë. Kërkesat e tij të pandërprera e këmbëngulëse seksuale, e çuan te vdekja, ndërsa po lindte fëmijën. Ajo ishte shumë e dobët dhe shumë e brishtë për të lindur një djalë trashëgimtar të madh e të fortë, siç deshi im atë, ndaj vdiq. Mjeku erdhi shumë vonë. I njof-tuar nga një lajmës që e bëri rrugën me biçikletë, ai erdhi duke u rrokullisur me të në dyzet milje udhë mes arave. Kur mbërri-ti, nëna tashmë ishte rehatuar në shtratin e vdekjes, e sëmurë, e pagjak, shfajësuese.

5. (Por përse ai nuk erdhi hipur në kalë? Ishin biçikletat në modë në ato kohë?)

6. Unë nuk e pashë tim atë tek sillte mes rrafshinave nusen e tij në shtëpi, sepse isha në dhomën time të errët në anën perëndi-more, duke ngrënë veten përbrenda dhe duke pritur të më vinte dita ime. Unë duhej të isha treguar e gatshme t'i përshëndesja

me buzëqeshje dhe t'u ofroja atyre çaj, por nuk e bëra këtë. Zëre se s'isha aty. Nuk isha munguese. Im atë s'e vuri re mungesën time. Për tim atë, kisha qenë munguese tërë jetën. Ndaj, në vend që të bëja ngrohtësi gruaje në zemër të kësaj shtëpie, isha një zero, hiçgjë, vakum, drejt të cilit të gjithë rrëzohen e bien brenda, një shtjellë, zëshurdhër, gri, një fresk shtjellor, që ecën korrido-reve, e braktisur, hakmarrëse.

7. Nata ra dhe im atë dhe gruaja e tij e re, u hodhën të dalldisur në dhomën e gjumit. Së bashku ata përkëdhelin mitrën e saj, duke parë si ajo do dridhet e lulëzojë. Ata përdridhen; ajo e vë atë cik më cik në tulin e vet; qeshin mbyturazi dhe ofshajnë. Këto janë kohë të bukura për ta.

8. Në një shtëpi të formësuar nga fati si shkronja H, kam jetuar gjithë jetën time, në një zonë me shkëmbinj dhe diell, e qerthulluar brenda disa miljeje teli, duke e vërtitur zvarritjen time nga dhoma në dhomë, duke kanosur shërbëtorët; vajzë e sertë e babait të zymtë. Perëndim pas perëndimi dielli, ne i kemi dalë para syve njëri-tjetrit, për shkak të të ngrënit monoton: mishit të deleve, patateve, kungullit, që e hanim me duar të ngathëta. Ka të ngjarë të kemi folur? Jo, ne nuk flisnim, i kemi dalë përballë njëri-tjetrit të heshtur dhe ndiqnim me mend rrugën tonë nëpër kohë, përballnim sytë tanë, sytë e tij të zinj dhe sytë e mi të zinj, trashëguar nga ai, duke u endur të hutuar nëpër fushat e imagjinatës. Pastaj, shkonim të flinim, të ëndërronim alegoritë e dëshirës së penguar, të tillë që, as shenjtërisht nuk jemi të zotët ta shpjegojmë; mëngjeseve bënim garë me asketizëm të akullt, se cili do të ishte më herët në këmbë, për të ndezur zjarrin në vatrën e ftohtë. Jetë ferme.

9. Në korridorin e hijesuar, ora shënon kohën ditë e natë. Unë jam ajo që e mban këtë orë të kurdisur dhe, nga dielli dhe almanaku, një herë në javë, i ndreq saktësinë. Koha në fermë, është si

koha e gjithë botës, asnjë grimë ndryshe. E mbaj me vendosmëri kohën e verbër, kohën subjektive të zemrës, me shpërthime emocionesh dhe zvarritje mërzish: pulsi im do të rrahë me rrahjen e rregullt njësekondëshe të qytetërimit. Një ditë, ndonjëri nga shkollarët që ende s'ka lindur, do ta pranojë atë orë, si vegla që u mati kohën të pacivilizuarve. Por, a do ta njohë ndonjëherë ai, dëshpërimin dhe vetminë e kohës së gjumit të pasdrekes, në shtëpitë e freskëta e të blerta me tavane të larta, ku vajzat e kolonive qëndrojnë duke i numëruar orët symbyllur? Toka është plot me beqare dhe të dëshpëruara, siç jam edhe unë, humbëse të historisë, si brumbuj të trishtë në shtëpitë e të parëve tanë, duke ua ruajtur të tepërt shkëlqimin enëve të bakrit dhe duke ndenjuri mënjanë nga e keqja. Kur ishim të vogla, mbështeteshim tek etërit tanë autoritarë, tani jemi virgjëresha hidhnake, përjetë të djegura. Fëmijëria të dhunon: dikush me këtë përfytyrim duhet të studiojë thelbin e së vërtetës.

10. Unë jetoj, vuaj, jam këtu. Po qe e nevojshme, me finokëri dhe pabesi, luftoj kundër të qenit humbëse e historisë. Jam një beqare me ditar të mbyllur, por jam dhe diçka më shumë se kaq. Jam një ndërgjegje e trazuar, por jam, po ashtu, edhe më shumë se kaq. Kur të gjitha dritat shuhen, unë buzëqesh në errësirë. Dhëmbët e mi vezullojnë, ndonëse askush s'do ta besonte këtë.

11. Ajo më afrohet nga pas, një aromë luleportokalli dhe afsh, më rrëmben prej supesh. – Unë nuk dua të jesh e zemëruar, e kuptoj se ndjehesh e trazuar dhe jo e lumtur, por nuk ka shkak për këtë. Do të doja që këtu, të gjithë së bashku, të ndjehemi të lumtur. Do bëj gjithçka, vërtet gjithçka, që kjo të ndodhë. A nuk më beson?

Vështroj ngultas në pjesën e futur të oxhakut; hunda ime fryhet dhe skuqet.

-Dua të jemi një familje e lumtur, - murmuron ajo, duke ardhur rrotull, - ne të tre së bashku. Dua të mendosh për mua si për një

motër, jo të më shohësh si armike.

Shikoj buzët e plota të kësaj gruaje të nginjur.

12. Ishte një kohë, kur e kuptova se, nëse do të flisja ca si tepër, mund t'ia zbuloja vetes se çdo të thotë të jesh një beqare e zemëruar në zemër të askundit. Por, sado që unë nuhata në çdo anekdotë, siç bën qeni mbi pirgun e vet, nuk gjeta asgjë nga shtrirja marramendëse e asaj që shënon fillimin e një jete të dyfishtë. E etur të formoj fjalët që do të më përshtatin në tokën e mitit dhe heroinës, jam ende këtu e pashije, në një nxehtësi të mërzitshme vere që nuk kapërcehet vetë. Çka më mungon? Qaj dhe kërcas dhëmbët. Është ky vetëm pasion? Është ky thjesht përfytyrimi i një ekzistence të dytë mjaft të zjarrtë, që më bart mua nga një qenie e rëndomtë, në një qenie me domethënie dyfishe? A s'po dridhem në çdo pore nga një duf bezdisjeje? Kjo, ngase zemërimi im ndjen mungesë? A nuk jam një beqare disi e vetëkënaqur në oborrin e fermës së egër, në fund të fundit, ende e mbështjellë në përqaftimin e tërbimeve të mia? A dua vërtet të kapërcej tej vetes? Rrëfimi i zemërimit tim dhe vijimi i tmerrshëm i tij: jam unë ajo që ngjitem në këtë mjet lëvizës dhe mbyll sytë e bartem poshtë rrjedhës, nëpër këto rrëmbesa e pragje lumi, përmes thyerjeve të ujit, për t'u zgjuar e rifreskuar në grykëderdhjen e gjerë e të qetë? Çfarë automatizmi është ky, çfarë çlirimi do të më sjellë mua, por, pa çlirim, cili është thelbi i rrëfimit tim? A e ndjej të tepërt nëpërkëmbjen në fatin tim prej beqareje? Kush është pas shtypjes sime? Ti dhe ti, them e tulatur në hi, duke shënjuar me gisht tim atë dhe njerikën. Por, pse nuk ika me vrap prej tyre? Sa kohë ekziston një vend tjetër ku ta bëja jetën time, ka gishta parajsorë që, po ashtu, do të më shënjonin dhe mua. Apo unë, që deri tani nuk e njoha veten, e tani medet, e njihkam, jam e ruajtur për një fat shumë më të ndërlikuar: me kokën të munduar e të kthyer poshtë, si një paralajmërim për ata që e duan tërbimin e vet, por u mungon tërë përfytyrimi i rrëfimit tjetër? Por ç'rrëfim tjetër ka për mua? Martesa me djalin e dytë të

fqinjit? Unë nuk jam një fshatare e lumtur. Jam një virgjëreshë e zymtë fatkeqe, dhe rrëfimi im, është imi, edhe po të jetë rrëfim i mërzitshëm, i errët, i verbër, i trashë, i mjerë, që s'i dihet kuptimi dhe as variantet e shumta të mundshme e të lumtura, që s'u shkruan ndonjëherë. Unë jam unë. Personazhi është fat. Historia është përëndeshë. E bezdisur, e bezdisur, e bezdisur.

13. Engjëlli, që është nganjëherë siç dihet, Engjell i veshur në të zeza, vjen t'i mbrojë fëmijët e njerëzve të zinj nga kolla dhe ethet. Tërë ashpërsia e tij e njohur nga të gjithë, kur vjen të kujdeset për të sëmurët, shndërrohet në një dhembshuri të vazhdueshme. Natë pas nate, ulet së bashku me fëmijët qaramanë, apo me gratë në punë, duke ua sjellë gjumin. "Një engjell nga qielli!", thonë ata, sytë e tyre joshës, janë plot afsh. Zemra e tij këndon. Në luftë, engjëlli u ndriçon të plagosurve orët e fundit. Ata vdesin me buzëqeshje në buzë, tek kundrojnë engjëllin, tek i shtrëngojnë dorën. Rezervat e dhembshurisë së tij, janë pa kufi. Ai ka nevojë të jetë i nevojshëm. Po të mos ia kishte nevojën kush, ai do të ishte i hutuar dhe me shpresa të djegura. A nuk shpjegon kjo gjithçka?

14. Të kishte qenë im atë një njeri më ndryshe, do të kishte pasur një vajzë më të mirë. Por ai kurrë s'pati nevojë për gjësend. E skllavëruar nga nevoja që të jem e nevojshme, u solla përreth tij si një hënë. Kështu, vetmia ime bëri përpjekje qesharake në psikologjinë e shkatërrimit tonë. Të sqarosh, do të thotë të harrosh, të jesh e sqaruar, do të thotë të jesh e harruar, por unë, shprejsoj dhe frikem, se jam një e pashpjegueshme, dhe që nuk harroj. Çfarë tkurret ende brenda meje dhe nuk do që të dalë në dritë? A kam unë vërtet ndonjë sekret, apo ky hutim para vetes, është vetëm mënyra më e mirë e mistifikimit tim, është gjysmë kërkim? A besoj unë vërtet se kështu, e zënë në të çarën mes nënës sime të butë dhe unit tim prej fëmije, rri çelësi për këtë beqare të zymtë të mërzitur? Vazhdo të jetosh vetë, kjo është pëshpërma që dëgjoj në thellësinë time.

15. Ana tjetër e imja, tani që po flas për vetveten, është dashuria për natyrën, veçanërisht për jetën e insekteve, për jetën domethënëse të ikjes me vrap, që vazhdon rrotull toptshit të bajgës dhe nën çdo gur. Kur isha vajzë e vogël (lakadredho, lakadredho!) ulesha në pluhur tërë ditën e lume me një beretë të zbukuruar skoceze, luaja me miqtë e mi, brumbujt, të përhimtit, të zeshkstit dhe ata të zinjtë, paksa më të mëdhenj, që ua kam harruar emrat, por që pa vështirësi mund të gjenden në ndonjë enciklopedi, dhe me mikeshat e mia, thnegëlIngrënëset, që bënin kurthe të vogla konike dhe elegante rëre, në fundet e të cilëve hidhja milingtonën e rëndomtë të kuqe, dhe, herë pas here, fshehur nën një gur të sheshtë, një përçollak foshnjë të trallisur e të zbehtë, që e shtypja me një shkop, pasi atëbotë mësova se përçollakët ishin të këqinj. Unë nuk kam frikë nga insektet. E lija fermën me godina prapa vetes dhe ecja këmbëzbathur përgjatë shtratit të lumit, rëra e zezë e nxehtë kërciste nën shputat e mia, e ngjeshur mes gishtave të këmbës. Ulesha në stomet e rërës me fustanin e palosur dhe ndjeja mykun e ngrohtë të kofshët e mia. Unë nuk kam drojë, jam e sigurt, edhe po të vinte puna, ndonëse s'e di si vjen puna, rreth të jetuarit te ndonjë kasolle me baltë, ose nën ndonjë strehore me pjerrje degësh, janë në rrafshinë, duke ngrënë hiçgjë e duke folur me insekte. Madje, përmes vajzës së vogël, kanë ndritur lehtë tiparet e zonjës së moçme të çmendur, dhe njerëzit e zeshkët, të cilët fshiheshin pas kaçubave, duhet të kenë nënqeshur, sepse i dinin të gjitha.

16. Unë u rrita me fëmijët e shërbëtorëve. Flisja, siç flisnin ata, para se të mësoja të flisja, siç flas tani. Luaja lojërat e bastunit dhe gurit, para se të dija se do kisha një shtëpi të bukur si kukull, ku do të jetoja me babain e nënën dhe Peterin e Janen, secili në shtratin e vet dhe me rrobat e pastra të gatshme në sënduk, me sirtarët që i rrëshqitnin brenda e jashtë, në kohën kur qeni Nan dhe macja Felix dremnitnin para qymyrit të kuzhinës. Me fëmijët e shërbëtorëve, kërkoja e zhbiroja rrafshinën për rrënjë ghamma-



ShtepiaeLibrit.com

Libraria ime...

Si mund të porosisni libra nga ShtepiaeLibrit.com ?

Përshëndetje mik i librit!

Prej 3 vitesh, **ShtepiaeLibrit.com** shërben si një **librari virtuale** ku ju mund të **informoheni** dhe të **porosisni** libra direkt nga interneti.

Ne të specializuar në **promovimin, tregtimin** dhe **dërgimin** e librave shqip.

Ne dërgojmë porosi **në çdo vend të botës**, prandaj për të porositur libra mjafton të na jepni një **adresë të saktë postimi** dhe të **konfirmoni pagesën tuaj**. Më pas librat do t'ju vijnë me postë në adresën e porositur nga ju.

Aktualisht, **mënyrat kryesore të pagesës** për porositjen e librave janë këto:

1. duke paguar me **kartat e internetit: Visa, MasterCard, American Express** ose **Discover**
2. duke paguar me **PayPal.com** drejt adresës tonë: **sales@shtepiaelibrit.com**
3. duke i transferuar fondet në llogarinë tonë bankare në **Shqipëri** (ose në **Kosovë**)
4. duke i dërguar fondet nëpërmjet shërbimeve **Western Union, MoneyGram**, etj.

Pagesat mund të kryhen në **Euro, USD, Paund** dhe sigurisht **Lekë**. Porositë me **kartat e internetit** dhe me **PayPal** mund të kryen direkt nga faja jonë. Për **transfertat bankare** apo **dërgesat** me Western Union, MoneyGram, etj, ju lutem na kontaktoni paraprakisht me email që t'ju dërgojmë informacionet që do t'ju nevojiten.



Për klientët tanë nga **Shqipëria**, ne ofrojmë mundësinë e blerjes së librave **në lekë pranë librarisë tonë në Tiranë** (afër qendrës) ose **me pagesë bankare** brenda Shqipërisë. Postimi i librave brenda Shqipërisë bëhet **FALAS** nëse porosisni më shumë se një libër. Porositë brenda Tiranës mund t'i sjellim edhe dorazi.



Për klientët tanë nga **Kosova**, përveç pagesave nëpërmjet internetit ne ofrojmë edhe mundësinë e pagesës **me transfertë bankare në Euro**. Pagesat kryhen pranë **ProCredit Bank në Kosovë**. Librat ju vijnë me postë për 1 javë nga dita e pagesës.

Mirëpresim çdo pyetje apo kërkesë tjetër që mund të keni.

--

Elvisi & Gjergji

Administratorë

E-mail: admin@shtepiaelibrit.com **Tel.** +355 4 450 3262 **Mobile:** +355 68 60 52 510

Website: <http://www.ShtepiaeLibrit.com>

Adresa jonë: Libraria "Shtëpia e Librit"

Rruga e Barrikadave, Galeria Nasional (ish-Kinema 17 Nëntori), Kati I, Tirana, Albania.

